



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2444 Prot.

Vlorë më, 26.01. 2026

VENDIM

Nr. 7, datë 26.01 2026

PËR
NJË SHTOJCË NË MARRËVESHJEN E PËRBASHKËT KONSORCIUMI PËR
ZBATIMIN DHE MENAXHIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË
STUDIMIT, MASTER PËR 'MBROJTJEN DHE MENAXHIMIN E MJEDISIT
DETAR' TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Vendimeve të Bordit të Administrimit nr. 35, datë 31.07.2024 dhe nr. 39, datë 21.11.2022; propozimit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, përcjellë me shkresën 10-/1, datë 08.01.2026; si dhe referuar Vendimit nr. 7 datë 20.01.2026 të Senatit Akademik; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26.01.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore për një shtojcë në Marrëveshjen e Përbashkët Konsorciumi për Zbatimin dhe Menaxhimin e Programit të Përbashkët të studimit, Master për 'Mbrotjen dhe Menaxhimin e Mjedisit Detar'; sipas materialit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA